



Prishtinë, 11 nëntor 2014
Kodi i ZRRE-së: V_663_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14 pika 2.6 dhe Nenin 43, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184; dhe
- Shkresën / Njoftimin e Ndrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A të datës 23 tetor 2014 lidhur me vendimin e tyre për të mos aplikuar për ngritjen e tarifave;

në seancën e mbajtur me datë 11 nëntor 2014, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat e ngrohjes qendrore për Ndrohtoren e Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2014/2015, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B".

Arsyetim

1. Me datën 23 tetor 2014, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar shkresën nga Ndrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos SH. A, me anë të së cilës njoftohet ZRRE-ja se, menaxhmenti i NQ Termokos, në koordinim me Bordin e drejtorëve, është dakorduar që mos të aplikoj për tarifat e sezonit të ngrohjes 2014/2015. Në këtë njoftim gjithashtu theksohen edhe arsyet për një vendim të tillë:
 - Realizimi i projektit të kogjenerimit, që sipas dinamikës së kryerjes së punimeve pritet të përfundoj kah mesi i nëntorit, pra kur pritet edhe të startoj furnizimi me ngrohje nga ky projekt. Rrjedhimisht fillimi i prituri i furnizimit me ngrohje nga kogjenerimi është një muaj pas fillimit zyrtarë të sezonit të ngrohjes.
 - Ndryshimet në operim, ndryshimet në kostot e përgjithshme si dhe ato në furnizim me ngrohje pritet të jenë të konsiderueshme si rrjedhojë e projektit të kogjenerimit. Për këtë si dhe duke mos qenë të sigurt në realizimin e tërësishëm të projektit është konsideruar e vështirë të bëhen planifikime reale për tu përfshirë në aplikacion tarifor.
 - Është vlerësuar se nevojitet se paku një sezonë e ngrohjes për të marrë të dhëna dhe informata të mjaftueshme për kostot operative dhe kostot kapitale, dhe për sasitë e prodhuara të energjisë termike nga kogjenerimi. Pra, parashikohet që në sezonin e ardhshëm 2015/2016 të paraqitet një aplikacion i kompletuar dhe i bazuar në parashikime reale.



2. Për vendosjen e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE ka marr parasysh arsyetimet e paraqitura në shkresën e NQ Termokos të datës 23 tetor 2014, të cilat i ka konsideruar të drejta dhe të argumentuara.
 3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresës së NQ Termokos të datës 23 tetor 2014, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e tarifave të Ngrohtores së Qytetit Termokos SH. A, për sezonin e ngrohjes 2014/2015 është dhënë në tabelën e mëposhtme:

TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT TERMOKOS SH.A PËR SEZONIN E NGROHJES 2014/2015
--

Tabela A . TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE
--

NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komerเชียลë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.07 [€/m ² për muaj]	0.08 [€/m ² për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.77 [€/m ² për muaj]	0.92 [€/m ² për muaj]

Tabela B .TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	0.66 [€/kW për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	45.50 [€/MWh]

- III. NQ Termokos SH. A duhet ta publikoj këtë vendim, brenda pesë (5) ditëve të punës pas marrjes së vendimit dhe publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë që të auditoj regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos SH.A. për të verifikuar realizimin e të Ardhurave dhe Kostove në sezonin 2014/2015.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, Kryesues

Merita Kostari, Anëtare

Krenar Bujupi, Anëtar